

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6763  
E hënë, 21 nëntor 2022  
çmimi 0.40

## Asambleja Parlamentare e NATO-s miratoi raportin për Ballkanin Perëndimor



FAQE 3

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

VËRSHIME NË KOSOVË DHE SHQIPËRI | FAQE 4-5

# VËRSHIMET SHKAKTUAN DËME NË EKONOMITË FAMILJARE, BIZNESE DHE NË BUJQËSI



Reshjet e shiut që kanë nisur nga dita e shtunë e kanë vazhduar edhe të dielën kanë krijuar vështirësi dhe probleme në shumë komuna të Kosovës, duke shkaktuar rrëshqitje të

dheut, mbyllje të sistemit të kanalizimeve dhe vështirësi në qarkullim. Vërshimet kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme edhe në ekonomitë familjare, biznese dhe në

bujqësi. Edhe Shqipëria është përfshirë nga reshje të shumta shiu. Situata është përkeqësuar të dielën, ku si pasojë e përmbytjeve, dy persona, babë e bir, janë zhdukur

## AKTUALE



**BULLGARIA AKUZON  
PESË PERSONA PËR SULMIN NË  
STAMBOLL** F. 2

**KONGRESMENI RITCHIE TORRES  
VIZITON GLOGJANIN** F. 6

**KOMF-I KËRKON JETË DINJITOZE  
PËR ÇDO FËMIJË NË KOSOVË** F. 3

## EKONOMI



**KOSOVA FITON RASTIN KUNDËR  
KOMPANISË FINANCIARE "IUTE  
CREDIT"** F. 8

## SPORT



**FUTBOLLI NË FESTË, BOTËRORI NIS  
RRUGËTIMIN MES FISHEKZJARREVE  
DHE NJË CEREMONIE MADHËSHTORE!  
EKUADORI FITON ME 2 GOLA NDAJ  
KATARIT** F. 10



**GJOBITJA PËR  
SHOFERËT ME  
TARGA ILEGALE  
SERBE NIS NGA  
22 NËNTORI** | FAQE 3



**MUSK  
RIKTHEN  
LLOGARINË E  
TRUMPIT NË  
'TWITTER'** | FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Bulgaria akuzon pesë persona për sulmin në Stamboll

**SOFIJE, 20 NËNTOR** - Autoritetet bullgare kanë akuzuar pesë persona për dhënien e ndihmës për njërin prej të dyshuarve që kreu sulmin e fundjavës së kaluar në qendër të Stambollit. Nga ky sulm në Sheshin Taksim u vranë gjashtë persona dhe u plagosën 81 të tjerë. Kështu tha më 19 nëntor, Siika Mileva, zëdhënëse e prokurorisë së Sofjes.

Ministri i Brendshëm i Turqisë, Suleyman Soyulu, tha më 14 nëntor se policia e këtij vendi ka arrestuar 22 persona të dyshuar për sulmin në Stamboll. Në mesin e të arrestuarve ishte edhe personi që ka vendosur bombën.

Turqia ishte goditur nga një seri bombardimesh vdekjeprurëse edhe më 2015 dhe 2017, përgjegjësinë e të cilave e kishin

marrë grupi militant Shteti Islamik dhe militantët kurdë. Nga këto sulme janë vranë mbi 500 civilë dhe personel i sigurisë.

Turqia për një kohë të gjatë lufton kundër militantëve kurdë - apo Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit, që njihet si organizatë terroriste nga Turqia, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.



## Vuçiçi: Nuk jam optimist për takimin e Brukselit

**BEOGRAD, 20 NËNTOR** - Presidentit i Serbisë, Aleksandar Vuçiçi, tha se nuk është optimist për takimin e 21 nëntorit në Bruksel, ku do të takohet me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. "Unë do të shkoj në Bruksel. Nuk mendoj se mund të bëjmë diçka, por po shkoj që të mos jap arsye që Serbia të akuzohet se nuk dëshiron të bëjë asgjë", tha Vuçiçi më 20 nëntor në një intervistë për televizionin "Prva". Vuçiçi ka konfirmuar se takimi do të fillojë në orën 8 në mëngjes dhe ka ripërsëritur kushtet e Serbisë për formimin e Asociacionit

të Komunave me Shumicë Serbe dhe anulimin e vendimit për targa.

Zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, tha për "Radion Evropa e Lirë" se Kurti udhëton sot për në Bruksel, ndërkaq takimi me Vuçiçin mbahet të hënën.

Takimi mes palëve pritet të ndodhë një ditë para se të nisë zbatimi i fazës së dytë për riregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe e cila parasheh gjobë prej 150 eurosh.

Policia e Kosovës ka thënë të dielën se më 22 nëntor nis shqiptimi i gjobave.



## Musk rikthen llogarinë e Trumpit në 'Twitter'



**UASHINGTON, 20 NËNTOR** - Pronari i ri i rrjetit social "Twitter", Elon Musk, ka thënë se llogaria e ish-presidentit amerikan Donald Trump është rikthyer pas një sondazhi online. "Njerëzit kanë folur", shkroi Musk, duke thënë se 51.8 për qind e më shumë se 15 milionë përdoruesve të "Twitter"-it votuan për rikthim.

Por, Trumpi mund të mos kthehet në platformë, pasi më herët tha se "nuk shoh ndonjë arsye për këtë".

Në muajin janar 2021 "Twitter" ka njoftuar se llogaria e ish-presidentit Trump ishte "pezulluar përgjithmonë... për

shkak të rrezikut të nxitjes së mëtejshme të dhunës", pas trazirave në të cilat protestuesit sulmuan objektet qeveritare amerikane në Uashington.

Në maj, Musk, tha se nëse oferta e tij për ta blerë "Twitter"-in është e suksesshme, ai do ta anulonte suspendimin e Trumpit nga kjo platformë.

Vendimi i "Twitter"-it për pezullimin e llogarisë së ish-presidentit amerikan ishte "moralisht i gabuar dhe absolutisht budallallëk", tha ai. Llogaritë e Trumpit janë të pezulluara edhe në platformat e tjera.

Kompania "Facebook" pati njoftuar në qershor të vitit 2021 se do të zgjasë për dy vjet pezullimin e llogarive të ish-presidentit amerikan në "Facebook" dhe "Instagram", pasi i pezulloi ato në janar.

Në tetor të vitit të kaluar Trumpi njoftoi se do ta hapë rrjetin e vet social.

Që nga ndalimi Trumpi përmes mënyrave të ndryshme ka synuar për ta rifituar praninë e tij në mediet sociale. Ai kishte 88 milionë ndjekës në "Twitter" dhe e ka përdorur shumë këtë rrjet social për të komunikuar me ndjekësit.

## Kryeministri britanik viziton Kievin

**KIEV, 20 NËNTOR** - Kryeministri britanik Rishi Sunak ka vizituar për herë të parë Kievin që nga marrja e detyrës në fund të tetorit. Kështu njoftoi presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky. "Që nga ditët e para të luftës, Ukraina dhe Britania e Madhe kanë qenë aleatët më të fortë", tha ai në

një postim në "Facebook". Sunak njoftoi se Londra do t'i japë Kievit ndihmë ushtarake në vlerë prej 59.4 milionë dollarësh, duke përfshirë armë kundërajrore dhe teknologji antidronë. Ish-kryeministri britanik Boris Johnson kishte deklaruar në korrik se mbështetja britanike për

Ukrainën "nuk do të lëkundet" pavarësisht se kush do të bëhet kryeministri i ardhshëm i vendit të tij.

Këtë e kishte thënë edhe pasardhësja e tij, Liz Truss, e cila qëndroi në pushtet vetëm 44 ditë.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.



# Asambleja Parlamentare e NATO-s miratoi raportin për Ballkanin Perëndimor

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Në punimet e sesionit të 68-të të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, që po zhvillohen në Madrid të Spanjës, Asambleja miratoi Raportin për Ballkanin Perëndimor. Raportin e kundërshtoi udhëheqësi i delegacionit serb, i partisë së kryetarit serb Vuçiq, në pushtet, duke pretenduar se raporti përmban të pavërteta për Kosovën, ngaqë nuk është shtet, duke e quajtur 'Kosovo i Metohija', si dhe duke deklaruar se "jemi duke biseduar për çështjen e statusit të Kosovës". Gjithashtu, duke pretenduar që bazat ushtarake ruse në Serbi janë për qëllime humanitare, se nuk ka tension të nxitur nga Serbia etj. Pas kërkesës së tij, Asambleja ia kaloi fjalën kryetarit të delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Driton Hyseni, i cili argumentoi se pretendimet e delegacionit serb, respektivisht kryetarit të këtij delegacioni, janë tërësisht të pavërteta. Ai tha se Kosova është shtet sovran, i shpallur në vitin 2008 e i njohur nga 117 shtete të botës. Për më tepër, ai theksoi se pavarësia e saj është vërtetuar edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Hyseni vazhdoi duke potencuar faktin që vetëm pak zyrtarë serbë akoma Kosovës i drejtohen me emrin "Kosovo i Metohija" por, në fakt, Kosova është vetëm Kosovë. Sa iu takon bazave ruse në Serbi, Hyseni sqaroi se nuk bëhet fjalë për baza për qëllime humanitare, por ato janë baza ushtarake, të shumta në numër, e një pjesë e madhe e tyre janë të vendosura përgjatë kufirit me Kosovën. Ai tha se Serbia është duke u armatosur me armë ruse dhe kineze.

Gjithashtu, Hyseni shtoi se i gjithë tensioni në veri të Kosovës është produkt i influencës dhe ndikimit që Beogradi ka te minoriteti serb që jeton në veri të Kosovës. Pas fjalës së kryetarit të delegacionit nga Kosova, raporti u hodh në votim dhe, përpos dy abstenimeve, të gjitha votat e tjera ishin pro, që do të thotë se asnjë nga deklarimet e kryesuesit të delegacionit serb nuk u morën parasysh.

Mbështetje të madhe në këto diskutime Kosovës i dha anëtarja e Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, Harriett Baldwin, duke bërë thirrje për njohje të realitetit në Kosovë dhe duke i ftuar shtetet anëtare të NATO-s për njohje të shtetësisë së Kosovës.

Gjithashtu, gjatë sesionit të djeshëm, kryetarja e delegacionit të Shqipërisë, Mimi Kodheli, njëherësh nënkryetare e



Asamblesë Parlamentare të NATO-s, në diskutimin e saj të zhvilluar në Komisionin Politik të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, iu drejtua ministrit për Punë të Jashtme, Evropë dhe Bashkëpunim të Spanjës, Albares, me kërkesën e Shqipërisë për ta adresuar çështjen e Kosovës nën një perspektivë të re nisur nga marrëdhëniet e bashkëpunimit të hershëm që kanë karakterizuar

Spanjën me rajonin e Ballkanit. Në përgjigje, ministri Albaros tha se Spanja mbështet dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe se nuk do të jetë pengesë për zhvillimin e rajonit. Delegacioni i Kuvendit të Kosovës, i përbërë nga Driton Hyseni, kryesues dhe Xhavit Haliti, anëtar, janë duke zhvilluar takime me delegatët pjesëmarrës dhe janë duke marrë pjesë në diskutimet të cilat në këtë sesion

janë të fokusuar në partneritetet e NATO-s, tek e ardhmja e politikës së dyerve të hapura, duke përfshirë diskutimet për pranimin e Finlandës dhe Suedisë, diskutimet për Konceptin e ri Strategjik të NATO-s, përshtatjen dhe modernizimin më të gjerë, qëndrimin me Ukrainën dhe përballjen me kërcënimin e Rusisë e çështje të tjera me rëndësi.

## Gjorbitja për shoferët me targa ilegale serbe nis nga 22 nëntori



PRISHTINË, 20 NËNTOR - Policia e Kosovës ka bërë me dije se edhe më 21 nëntor do të vazhdojë masa e qortimit të shoferëve me targa ilegale serbe, ndërkajmë 22 nëntor nis shqiptimi i gjobave. Shqiptimi i gjobave prej 150 eurosh, sipas policisë, do të zgjasë deri më 21 janar 2023. Deri më 20 nëntor janë shqiptuar rreth 1 740 qortime për shoferët e makinave me targa ilegale serbe. Për çështjen e planit të qeverisë për reregjistrimin e makinave që kanë targa të lëshuara nga

Serbia në RKS - Republika e Kosovës, të hënën në Bruksel pritet të zhvillohet një takim ndërmjet kryeministrit të Kosovës Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Kurti dhe Vuçiqi kanë konfirmuar takimin. Serbët në komunat veriore të Kosovës kanë paralajmëruar se do ta kundërshtojnë shqiptimin e gjobave ashtu siç kanë kundërshtuar gjithë vendimin e qeverisë për targa. Qeveria e Kosovës ka nisur ta zbatojë planin e saj nga 1 nëntori.

Plani për reregjistrimin e makinave me targa të lëshuara nga Serbia ka paraparë tri faza. Faza e parë përfshiu qortimin e shoferëve, e dyta parasheh gjobë deri në 150 euro për ata shoferë, e treta targa provuese. Zbatimi i këtij plani është paraparë të përfundojë më 21 prill dhe nga ajo datë parashihet që në komunikacion të lejohen vetëm makina me targa të ligjshme, RKS, apo Republika e Kosovës. Vendimi për targat ka tensionuar situatën në veri të Kosovës.

## KOMF-i kërkon jetë dinjitoze për çdo fëmijë në Kosovë

Prishtinë, 20 nëntor - Në ditën e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës, KOMF-i u ka bërë thirrje institucioneve të ndërhyjnë me veprime konkrete për të garantuar mbrojtje dhe mirëqenie për të gjithë fëmijët në Kosovë. KOMF ka theksuar se fëmijët viktimë të abuzimit seksual, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e përfshirë në punë të rënda dhe fëmijët viktimë të

abuzimit me substanca narkotike, kanë nevojë për mbrojtje dhe mbështetje të menjëhershme nga institucionet. "Vitet e fundit ka pasur rritje të vazhdueshme të numrit të rasteve të veprave kundër integritetit seksual të fëmijëve sikurse dhunimi, sulmi seksual etj. Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve janë duke ndodhur në ambiente si

familje, komunitet, madje edhe në institucionet e mandatuara për mbrojtje të fëmijëve si, për shembull, në institucione edukative, shkolla etj", thuhet në deklaratën e KOMF-it. KOMF-i apelon që të investohet urgjentisht në fuqizimin e shërbimeve ekzistuese dhe themelimin e shërbimeve që mungojnë për të garantuar që çdo fëmijë të gëzojë një jetë dinjitoze.





VËRSHIME NË KOSOVË DHE SHQIPËRI

# Vërshimet shkaktuan dëme në ekonomitë familjare, biznese dhe në bujqësi

Reshjet e shiut që kanë nisur nga dita e shtunë e kanë vazhduar edhe të dielën kanë krijuar vështirësi dhe probleme në shumë komuna të Kosovës, duke shkaktuar rrëshqitje të dheut, mbyllje të sistemit të kanalizimeve dhe vështirësi në qarkullim. Vërshimet kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme edhe në ekonomitë familjare, biznese dhe në bujqësi. Po ashtu, edhe Shqipëria është përfshirë nga reshje të shumta shiu. Situata është përkeqësuar të dielën, ku si pasojë e përmytjeve dy persona, babë e bir, janë zhdukur

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 20 NËNTOR** - Për shkak të reshjeve të shiut në disa komuna të Kosovës është raportuar për vërshime dhe vështirësi në qarkullim. Në Komunën e Junikut, sipas zyrtarëve komunalë të kësaj komune, situata e krijuar nga reshjet e shiut ka shkaktuar vërshime dhe përmytje. Demokrat Ganiqaj, drejtor për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim, ka thënë se është rritur niveli i lumit Erenik dhe disa fshatra dhe lagje po përballen me vështirësi. "Gjendja momentalisht është emergjente, por nën kontroll. Jemi me ekipet emergjente në terren, kemi rritje të shtratit të

lumit Erenik në disa pjesë në lagjen Berisha, lagjen Tofa. Po ashtu, ka rrëshqitje të dheut dhe dëmtim të rrugës në fshatin Jasiq. Te disa shtëpi që janë me bodrum ka përmytje", tha Ganiqaj.

Reshjet e vazhdueshme të shiut kanë shkaktuar vështirësi edhe në komunën e Vushtrrisë.

Kryetari i Vushtrrisë, Ferit Idrizi, ka dalë në terren pas situatës së krijuar nga reshjet e shiut. "Bashkë me Drejtorinë për Emergjencë që nga mëngjesi jemi nëpër fshatra e qytet për ta parë nga afër gjendjen e lumenjve pas reshjeve të mëdha të shiut. Falënderoj të gjithë operatorët vushtrrias që me makineritë e tyre janë në gjendje gatishmërie për intervenim", ka thënë ai.

Ferizi shton se lumi Sitnica ka rritje të nivelit dhe se aktualisht nuk ka rrezik për dalje nga shtrati. Në vitin 2021 nga reshjet atmosferike lumi Sitnica pati dalë nga shtrati dhe kishte shkaktuar vërshime të mëdha në rajonin e Vushtrrisë.

Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, përmes një

njoftimi në "Facebook", ka thënë se si pasojë e reshjeve të shiut ura në fshatin Vranoc të Vogël ka pësuar dëmtime të mëdha dhe është e pakalueshme. "Si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut është gjendje e rënduar në disa vendbanime të komunës së Deçanit, ku janë shkaktuar

vërshime, prandaj ju lutem të keni kujdes në rast të qarkullimit nëpër fshatin Baballoq, ndërsa ura në fshatin Vranoc të Vogël është e pakalueshme për shkak të dëmtimeve të mëdha. Komuna e Deçanit do të bëjë të pamundurën që t'ua ofrojë ndihmën e duhur të gjithë qytetarëve të saj deri në kalimin e kësaj situatë emergjente", ka thënë Ramosaj.

Edhe komuna e Pejës është përballur me vështirësi pas reshjeve të shiu, por se situata është nën kontroll nga ekipet emergjente. "Reshjet e mëdha atmosferike nga nata e mbrëmshme shkaktuan vërshime në disa zona të qytetit të Pejës. Megjithatë, situata aktualisht është e menaxhueshme dhe ekipet tona janë në gjendje gatishmërie", ka thënë kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri, i cili ka dalë në terren për ta parë gjendjen.

Në Istog raportohet se nga vërshimet janë shkaktuar dëme të konsiderueshme në ekonomitë familjare, biznese, në bujqësi. "Reshjet e mëdha që pasuan natën e mbrëmshme, si dhe sot gjatë ditës, shkaktuan vërshime në shumë zona si në: qytetin e Istogut, Vrellë, Studenicë, Orroberdë, Kaliqan,



Baicë, Lluga/Llukafc, Tomoc, Prigodë, Drejë, Shushicë, Kërrinë. Bashkë me ekipet emergjente jemi në terren duke bërë ndërhyrjet e nevojshme me makineritë që i kemi në dispozicion si komunë, bashkë me zjarrfikësit, Policinë e Kosovës, 'Hidrodrini'-n, 'Drinin e Bardhë' si dhe ato të firmave private të Istogut të cilat janë vënë në gatishmëri të plotë, pas krijimit të kësaj situatë. Për momentin gjendja është e menaxhueshme, rrugët janë të qarkullueshme, dëme ka të konsiderueshme në ekonomitë familjare, biznese, në bujqësi. Ne do të jemi në terren bashkë me ekipet emergjente deri në uljen e të reshurave për të ndërhyrë në zonat më kritike. Ditët në vijim komisionet tona do të dalin në terren që ta bëjnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara", ka thënë kryetari i Istogut, Ilir Ferati.

Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka dalë në terren pas vërshimeve në këtë komunë. "Vërshimet si një fenomen natyror që janë, me vështirësi menaxhohen, jo vetëm në Malishevë, por kudo në botë, dhe për këtë fakt ne kërkojmë mirëkuptim qytetar, dhe shpresojmë që dëmet të jenë sa më të vogla", ka theksuar Kastrati.

Vërshime ka pasur edhe në Mitrovicë. "Brenda kapaciteteve tona jemi duke marrë të gjitha masat e nevojshme, i kemi mobilizuar të gjithë operatorët e nevojshëm dhe së bashku me ta jemi në terren. Reshjet e dendura kanë bërë që niveli i ujit në lumenjtë e qytetit të Mitrovicës të rritet dhe kjo ka shkaktuar një situatë serioze, prandaj jemi duke vëzhguar situatën nga afër", është shprehur kryetari i komunës, Bedri Hamza.

Edhe kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, së bashku me drejtorin e Shërbimeve Publike, Bahri Selimi, kanë vizituar disa nga fshatrat e prekura nga vërshimet si fshatin Dobërdol, Bajcinë, Peran, Metehi, Pakashticë dhe Murgull, në të cilët është rritur niveli i ujit për shkak të daljes nga shtretërit e lumenjve si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut gjatë orëve të fundit. "Gjendja e përgjithshme në disa



fshatra nuk është aq stabile e shiu i pandërprerë po e vështirëson menaxhimin e situatës", ka theksuar ai. Pas reshjeve të mëdha që shkaktuan edhe vërshime në shumë pjesë të vendit, ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj, përmes një shkrimi në "Facebook" ka bërë me dije se janë duke e monitoruar situatën në terren.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës në një njoftim më 18 nëntor ka thënë se reshjet e shiut me intensitet dhe shtrirje të ndryshme territoriale pritet të vazhdojnë deri të hënën më 21 nëntor. Më të theksuara reshjet e

shiu, sipas Institutit, do të jenë nëpër disa pjesë të Kosovës, sidomos në Gjakovë, Junik, Deçan, Pejë, Istog, Klinë, Malishevë, Rahovec dhe vende të tjera.

Sipas Institutit, këto reshje mund të krijojnë kushte për vërshime të shpejta, të cilat mund të shkaktojnë vështirësi dhe probleme, sidomos të rrjedhat lumore me karakter malor në formë të rrëkeve të shpejta, duke shkaktuar rrëshqitje të dheut, mbyllje të sistemit të kanalizimeve dhe vështirësi në qarkullim.

Vërshime në Kosovë ka pasur edhe vitin e kaluar.

## Përkeqësohet situata e përmbytjeve në Shqipëri

Që nga orët e vona të së shtunës Shqipëria është përfshirë nga reshje të shumta shiu, e që për pasojë ka përmbytje në disa qarqe, kryesisht në zonat veriore. Situata është përkeqësuar pasditen e së dielës, ku si pasojë e përmbytjeve dy persona, babë e bir, janë zhdukur, pasi makina me të cilën udhëtonin u rrembye nga rrjedha e përroit në vendin e

quajtur "Grykë Lugje" në Shkrel të Malësisë së Madhe.

Policia shqiptare bëri me dije se në makinë ka qenë edhe vajza e mitur e 50-vjeçarit, e cila ka arritur të dalë dhe të shpëtohet nga një banor i zonës.

Ekipet e kërkim-shpëtimit nisën menjëherë operacionin, por ende nuk ka asnjë gjurmë të tyre. Në hyrje të qytetit të Shkodrës, në Harkun e Bërdicës, rruget është e përmbytur dhe për pasojë kalimi me automjete të vogla është i pamundur.

Situatën në zonën e Nënshkodrës e ka rënduar edhe hapja e portave të hidrocentraleve. "Si rezultat i prurjeve të shumta edhe në kaskadat e Vau Dejës dhe Komanit është bërë e mundur hapja e portave dhe shkarkimi i një sasive uji, që ka ndikuar për rëndimin e situatës. Situata paraqitet e rëndë, sidomos në Bahçallëk, Kuç, Bërdicë, ku kemi evakuimin e disa familjeve", tha prefekta Majlinda Angoni.

Ministria e Arsimit ka marrë vendim për ta pezulluar mësimin ditën e nesërme në 16 shkollat të qarkut të Shkodrës, për të shmangur çdo lloj rreziku për nxënësit dhe mësuesit. Veç Shkodrës, situata është serioze edhe në Lezhë dhe Dibër, ndërsa probleme ka edhe në qarqet Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Fier.

Në këtë qark është regjistruar edhe sasia më e madhe e reshjeve prej 190 milimetër shi. Pas kësaj situatë është mbledhur Komiteti i Mbrojtjes Civile për ta përcaktuar planin e masave parandaluese dhe lehtësuese për ta menaxhuar situatën në vazhdim, pasi meteorologët kanë parashikuar se reshjet do të vijojnë në gjithë territorin e vendit.

Lumenjtë Drin, Buna, Kiri etj. janë afër kuotës maksimale, por deri tani nuk kanë dalë nga shtrati. Ministria e Mbrojtjes u ka bërë thirrje Bashkive që të marrin masa.

Deri tani nuk ka një bilanc se sa është numri i banesave të përmbytura apo sa është sipërfaqja e tokës nën ujë. Autoriteti Rrugor Shqiptar ka njoftuar se reshjet e shiut me intensitet të lartë në të gjithë vendin kanë shkaktuar edhe rënie të gurëve dhe inerteve në disa akse rrugore, si: Bajram Curri-Valbonë, Hani Hotit-Tamarë, Vlorë-Orikum.



## Filluan punimet restauruese në ndërtesën e Qendrës Kulturore Hebraike në Prizren

Prizren, 20 nëntor - Kanë filluar punimet restauruese në ndërtesën e Qendrës Kulturore Hebraike, projekt ky i financuar nga Ministria e Kulturës.

Në Prizren, për t'i inauguruar këto punime, sot ishin ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, ambasadorja e Izraelit, Tamar Ziv, ambasadori gjerman Joern Rohde, shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, Michael Davenport, zëvendësambasadorja e ShBA-së, Alyson Grunder, nënkryetari i komunës së Prizrenit, Kujtim Gashi, Votim Demiri, kryetar i Bashkësisë Hebraike të Kosovës.

Ministria e Kulturës në njoftimin për medie ka theksuar se Qendra Kulturore Hebraike do të vendoset në

ndërtesën e ish-Hotel "Shumadija", aset i trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme. "Projekti i revitalizimit është hartuar nga Komuniteti Hebraik në Kosovë në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren. Paralelisht me ndërhyrjet revitalizuese, jemi në koordinim me Komunitetin Hebraik në Kosovë dhe shtetin e Izraelit, për të ndërmarrë hapat për zhvillimin e projektit të hulumtimit për ndërtimin e narrativës së ekspozitës mbi historinë e Komunitetit Hebraik në Kosovë, ekspozitë kjo e cila do të paraqitet në hapësirat e kësaj qendre", ka njoftuar Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.



## Tetë asistente për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta do të angazhohen në komunën e Gjilanit



**GJILAN, 20 NËNTOR** - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, priti në takim shëfën e zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Nona Zicherman dhe partnerët implementues "Kosovo Disability Forum", me ç'rast nënshkruan Planin e Punës dhe Memorandumin e Bashkëpunimit për angazhimin e tetë asistentëve për fëmijët/nxënësit me nevoja të

veçanta. Objektivi kryesor i planit të punës është që të gjithë djemtë dhe vajzat që nga ngjizja deri në 10 vjeç të kenë qasje dhe të përfitojnë nga shërbimet cilësore të integruara shëndetësore, shërbimet për zhvillimin në fëmijërinë e hershme dhe shërbimet arsimore, dhe familjet janë më reziliente dhe të fuqizuara për të kërkuar

shërbime cilësore në një mjedis të kujdesit gjithëpërfshirës. "Zotimi i përbashkët i komunës së Gjilanit dhe UNICEF-it është krijimi i një ambienti të përshtatshëm dhe zhvillues për fëmijët, të rinjtë dhe familjet ndërlidhet me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe Ditën Botërore të Fëmijëve që shënohet me datë 20 nëntor çdo vit", ka thënë kryetari Hyseni.

## 'Hidrodrini' bën thirrje për kujdes gjatë konsumimit të ujit të pijshëm



**PEJË, 20 NËNTOR** - Derisa po vazhdojnë reshjet atmosferike me intensitet të shtuar, qytetarëve që furnizohen me ujë nga KRU "Hidrodrini" u bëhet thirrje që të mos konsumojnë ujë të turbulluar pa e vluar atë. "Deri më tash (ora 13:30, koha e raportimit), situata mbetet nën kontroll, mirëpo bëhet thirrje që të gjithë konsumatorët të cilët vërejnë turbullira të ujit, mos ta konsumojnë për pije pa e vluar", thuhet në njoftimin e

"Hidrodrini"-t. Kompania thotë se në bazë të raporteve nga terreni thirrja vlen posaçërisht për zonën e Istogut, Deçanit dhe Klinës. Kryeshefi ekzekutiv ing. Agron Tigani mbetet në kontakt të vazhdueshëm me menaxherët e njësive operative, Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik, duke ofruar mbështetjen e plotë në rast të paraqitjes së nevojës edhe nga rajoni. Ekipet mobile vazhdojnë të mbeten në terren.

## Kongresmeni Ritchie Torres viziton Glogjanin

Deçan, 20 nëntor - "Lidhja e shqiptarëve me Amerikën është e pathyeshme", ka thënë lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, pas pritjes që i bëri në Glogjan kongresmenit Ritchie Torres.

"Në Glogjan sot kisha nderin të pres një mysafir të veçantë, mikun e madh të shqiptarëve, kongresmenin Ritchie Torres. Në mesin e shumë miqve, sot na nderuan edhe atdhetari i

madh Harry Bajraktari, ish-deputetja Vasfije Krasniqi Goodman, kryetarë të komunave, deputetë, bashkëluftëtarë e kolegë të tjerë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



## Kosova fiton rastin kundër kompanisë financiare “Iute Credit”

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka thënë se Kosova e ka fituar rastin në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit kundër kompanisë financiare “Iute Credit”. “Kemi arritur të kemi një epilog 100 për qind në favor të vendit”, tha Mehmeti në një konferencë për medie më 19 nëntor.

“IuteCredit” e kishte dërguar Kosovën në Arbitrazh në fillim të vitit 2020, pasi BQK-ja më 6 dhjetor të vitit 2019 pati mbyllur “Iute Credit” për shkak, siç është thënë, normës së lartë të interesit që kishte zbatuar gjatë dhënies së kredive për klientët, duke mos respektuar kështu planin e biznesit.

Guvernatori i BQK-së, Mehmeti, tha se në Arbitrazh u dëshmuua që vendimi për revokim të licencës të “IuteCredit”-it ka qenë i drejtë dhe i ligjshëm. “Gjatë periudhës së operimit të ‘Iute Credit’-it në Kosovë ky

institucion në vazhdimësi ka devijuar nga plani i biznesit në bazë të të cilit kishte marrë licencën për të operuar duke i sjell tregut diçka tjetër prej asaj që kishte premtuar”, tha Mehmeti.

“Iute Credit” në planin e biznesit, normat efektive të interesit i kishte paraqitur prej 34 respektivisht 26 për qind kurse, sipas zyrtarëve të Bankës Qendrore, ato kanë zbatuar norma efektive të interesit nga 80 deri në 236 për qind.

“Iute Credit” është kompani nga Estonia, e cila në tregun e Kosovës ka operuar dy vjet. Në Kosovë, sipas të dhënave të fundit të BQK-së, janë 30 institucione mikrofinanciare, prej tyre 13 me pronësi të huaj. Këto institucione kanë 149 njësi në gjithë territorin e Kosovës.

Institucionet mikrofinanciare japin pothuajse të gjitha llojet e kredive, sikur bankat komerciale, duke filluar nga kreditë për familje, kredi



bujqësore, kredi për biznese, për renovim, po ashtu edhe kredi për regjistrim të automjetit.

Vlera e kredive sipas BQK-së për muajin shtator në këto institucione ka arritur në 271

milione euro. Norma e interesit në kredi në këto institucione është 19.1 për qind.

## Rriten deri në 25 për qind çmimet e shitjes së banesave dhe qirave

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Çmimet për shitje të banesave në Kosovë, por edhe çmimet e qirave janë rritur rreth 25 për qind, rritje kjo e cila pritet të vazhdojë. Në Shoqatën e Ndërtimoreve të Kosovës dhe agjencitë e patundshmërisë thonë se rritja e çmimeve të shitjes dhe qirave të banesave ka ndodhur për shkak të inflacionit dhe rritjes së materialeve ndërtimore. Ata theksojnë se kjo rritje e çmimeve të materialeve ndërtimore është pothuajse 100 për qind në krahasim me vitin 2020.

Burim Halili, zyrtar i njëres prej agjencive të patundshmërisë në kryeqytet, tha se ka rritje të çmimit të qirave dhe shitjes së banesave për 25 për qind. Halili thekson se pritet të ketë sërish rritje të çmimeve, pasi materialet ndërtimore kanë ngritje të çmimeve. “Sa i përket çmimit të qeras dhe të shitjes kemi ngritje. Realisht kohën e fundit kemi ngritje të çmimeve pothuajse kudo, në të gjitha produktet, por në veçanti kemi te shitja. Ajo që ka ndikuar shumë te ngritja e çmimeve në shitje, është sepse janë shtrenjtuar materialet ndërtuese sikur janë armatura, betoni dhe të gjitha të tjerat. Afërsisht te shitja është ngritur në çmim diku 20 për qind deri 25 për qind, edhe te qiraja njëjtë, por kjo që ka ndikuar te shitja është rritja e materialeve”, tha Halili.

Sipas tij, në vazhdimësi pritet të ketë rritje të çmimeve. “Po pritet të ketë rritje për shkak se



materialet ndërtimore kanë ngritje, në veçanti armature për 50 për qind, kështu që unë mendoj se jemi në atë procesin e ngritjes dhe mendoj se duhen përafërsisht 5-6 muaj që të rritin çmimin stabil në bazë të materialeve që i kanë. Kemi objekte që janë ndërtuar më herët. Ata ndërtues ende kanë mundësi të ofrojnë çmime të tregut që kanë pasur më herët. E në momentin kur shiten edhe ato banesa, atëherë ne kemi të bëjmë me ndërtime që janë duke ndërtuar me materiale që janë të ngritura”, shtoi ai.

Nga Shoqata e Ndërtimtarëve të Kosovës thonë se rritja e materialeve ndërtimore është pothuajse 100 për qind në krahasim me vitin 2020. Rritjen e çmimit të qirave e ka arsyetuar edhe Faton Hoxha nga kjo shoqatë. “Rritja e çmimit të banesave është si rezultat i rritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore. Te materialet bazë, hekuri, çimento dhe druri, rritja është pothuajse 100 për qind. Nëse e krahasojmë me vitin 2020 ku nuk ka pasur lëvizje të madhe të çmimeve. Ndërsa rritja e çmimeve të qirasë ndoshta

mund ta arsyetohet me inflacionin që po ndodh”, tha Hoxha.

Ai e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për menaxhimin e buxhetit. Sipas tij, kjo duhet të investojë në projektet që i ka planifikuar për këtë vit. “Qeveria kish me qenë më se miri projektet e veta, ato që i ka planifikuar për vitin 2022, që janë projekte kapitale, që janë në masë rreth 700 milionë euro e që i ka harxhuar vetëm 20 për qind të tyre, ndihmese e madhe kishte me qenë ta investojë parinë, mjetet në qarkullim dhe jo t’i

mbajë aty. Qeveria po krekoset se për vitin e ardhshëm është buxheti më i madh ndonjëherë, mirëpo duke shikuar numrat buxhetore këtë vit si është harxhuar buxheti këtë vit, mund të ndërrojë çfarëdo shifre e buxhetit, por nëse vazhdon me këtë menaxhim të mjeteve, kot janë numrat”, kritikon ai.

Mjaft të shqetësuar për rritjen e qirasë janë shprehur edhe qytetarët. Euron Hyseni, i cili është edhe qiradhënës, tha se kjo rritje e qirasë po i dëmton jashtëzakonisht shumë. “Qiraja është më shtrenjtë se vitin e kaluar për rreth 15 për qind. Kjo na dëmton shumë krahasuar me rrogat e vogla që janë në vend”, tha Hyseni.

Edhe Xhavit Berisha është shprehur i shqetësuar me rritjen e çmimeve. Ai thekson se vendi është në krizë ekonomike dhe këto rritje të çmimeve nuk mund t’i përballojnë qytetarët. “Është shumë keq për arsyeje se është krizë ekonomike, njerëzit nuk kanë para, pensionet dhe rrogat e vogla, kështu me rrit qiranë, nuk e di si mbesin gjallë ata njerëz. Ushqimi, barnat, të pensionuarve nuk u mbetet asgjë tjetër veç të vdesin”, tha Berisha. Bashkim Sylaj, banor në kryeqytet, tha se rritja e çmimeve është barrë e rëndë për qytetarët. “Barrë e madhe është për ata që duhet ta paguajnë qiranë. Është çmim i lartë, sidomos për ata që nuk i kanë kushtet”, tha Sylaj. /KP/

# Aleksandër Xhuvani më 1941: Gjergj Fishta predikoi unitet, vëllazëri dhe tolerancë

Nga: **Haqif MULLIQI**

Në pjesën D të “Ekstrakteve nga Kosova” të Foreign Office-it britanik, hasim edhe një artikull interesant, që është shkruar me rastin e përvjetorit të vdekjes të At Gjergj Fishtës (1871-1940) – siç shkruhet në këtë dokument, njërit ndër poetët e fundit epik të Shqipërisë, ku potencohet fuqishëm se “shpirti i Fishtës, gjegjësisht ai i vëllazërimit dhe i bashkimit, do të ngadhënjente në Shqipëri, tashmë, më shumë se herëve tjera”.

Ideali i tij, shkruhet në këtë artikull, që kishte qëllim të ushtronte një ndikim të madh tek inteligjencia dhe qytetaria shqiptare në këtë periudhë të kthesave të mëdha historike, pra ideali i Fishtës, Shqipëria etnike dhe e bashkuar, do të jetë ideal i çdo shqiptari që e do vendin e vetë dhe që është përcaktuar të punojë për vendin e tij. “Këshilla e tij (e Fishtës – plot. i H. M.) për të mos luftuar njëri kundër tjetrit, për të respektuar dhe për të qenë mirëpritës, por për të mos i besuar të huajit tash më është urgjentisht

më e nevojshme se më për”, shkruan ky artikull i shkruar nga Masar Sopot.

Në këtë dosje, britanikët sjellin edhe një aksent nga shkrimi “Ideali i Fishtës” i shkruar nga Aleksandër Xhuvani, gjithashtu në përvjetorin e vdekjes së epikut të shquar shqiptar Gjergj Fishta, të cilin, siç duket, ekspertët britanikë e shihnin si një prej frymëzuesve kryesor të patriotizmit shqiptarë si dhe një kampion të idesë së krijimit të një shteti të vetëm të shqiptarëve, një shteti në të cilin do të jetonin shqiptarët etnik, në trojet e tyre etnike dhe historike.

Komentuesi i këtij artikulli të Xhuvanit në përvjetorin e Fishtës, thotë se edhe ky shkrim tregon se sa të rëndësishme dhe frymëzuese ishin veprat dhe idetë e Fishtës për gjeneratat e ardhme shqiptare. “Ideali i Fishtës ishte Atdheu nëpërmes Zotit”, do të shkruaj Xhuvani, duke shtuar se kësaj ideje Fishta i ngeli besnik gjatë tërë jetës së tij.

“Ai gjithmonë predikoi: unitet, vëllazëri dhe tolerancë, pra tri unitetet kanë nevojë aq shumë shqiptarët e sotëm”, shkruan Aleksandër Xhuvani. /Telegrafi/



## KRIJUESI

Nga: **Jorge Luis BORGES**  
Përktheu nga origjinali  
Bajram Karaballi

Asnjëherë s’ishte përhumbur në kënaqësitë e kujtimeve. Ndjesitë rrëshqisnin mbi të, të çastshme dhe të gjalla; pluhuri i cinabrit të një poçari, kubeja e mbushur me yje, të cilët gjithashtu ishin dhe zota, hëna, prej të cilës kishte rënë një luan, lëmimi i mermerit nën mollëzat e ndjeshme të gishtave, shija e mishit të derrit të egër, që i pëlqente ta shqyente me dhëmbët e bardhë dhe të mprehtë, një fjalë fenikase, hija e errët që lëshon një heshtë mbi rërën e verdhëlleme, prania e detit apo e grave, vera e fortë, ashpërsinë e së cilës e zbuste mjalti, të gjitha këto mund ta mbushnin tej e tej hapësirën e shpirtit të tij. E njëjtte tmerrin por gjithashtu edhe tërbimin e guximin. Njëherë pat qenë i pari që ngjiti një mur armik. I ethshëm, kureshtar, i rastësishëm, pa ligj tjetër përveç kënaqësisë dhe mospërfilljes së menjëhershme, brodhi mbi tokën e shumëllojtë dhe pa, nga njëra anë e detit në tjetrën, qytetet e njerëzve dhe pallatet e tyre. Në çarshitë e populluara apo në rrëzën e një mali me majë të mjegullt, në të cilën fare mirë mund të banonin satirë, kishte dëgjuar histori të ndërlikuara, që i prit njësoj si dhe realitetin, pa thëlluar nëse ishin të vërteta apo të sajuara.



Dalëngadalë, universi i mrekullueshëm nisi ta braktiste; një mjegullnajë e paepshme ia fshiu linjat e dorës, nata i zbrazti yjet, dheu nën këmbët e tij u bë i pasigurt. Gjithçka largohej dhe trazohej. Kur e kuptoi se po ngelej i verbër, ia dha klithmës; nderi stoik nuk qe shpikur ende dhe Hektori mund t’ia mbathte pa u turpëruar. “Nuk do të shoh më (ndjeu) as qiellin e mbushur me llahtar mitologjik, as këtë fytyrë që vitet kanë për ta shndërruar”. Ditë e net të tëra shkuan mbi dëshpërimin e mishit të tij, por një mëngjes u zgjua, vështroi (pa

habi tashmë) gjërat e vagullta që e rrethonin dhe në mënyrë të pashpjegueshme ndjeu, si ai që shquan një melodi a një zë të njohur, se e gjithë kjo i kishte ndodhur më parë dhe se e kishte përballuar me frikë, por gjithashtu edhe me gëzim, shpresë dhe kureshtje. Atëherë u zhyt në kujtesën e vet, që iu duk e pambarimtë, dhe arriti të shkëpuste nga ajo marramendje kujtimin e humbur që shkëlqeu si një monedhë në shi, mbase, sepse kurrë nuk e kishte parë, përveçse, ndoshta në ndonjë ëndërr.

Kujtimi ishte ky. Një djalë tjetër e kishte poshtëruar dhe ai kishte vrapuar tek i ati e i kishte treguar ngjarjen. I ati e la të fliste sikur të ishte duke mos e dëgjuar apo duke mos e kuptuar dhe shkëputi nga muri një thikë të bronzitë, magjepsëse dhe e plotpushtetshme, të cilën djaloshi e kishte lakmuar ethshëm. Tani e kishte në duar dhe habia e zotërimit e anuloi poshtërimin e pësuar, por zëri i të atit po thoshte: “Le ta marrë vesh dikush se tani je bërë burrë”, dhe zëri mbartte një urdhër. Nata i kishte verbuar shtigjet; i shtrënguar pas

thikës, tek e cila parandiente një forcë magjike, zbriti brinjën e rrëpirët që përthurte shtëpinë dhe vrapoi në breg të detit, duke ëndërruar se qe Ajaksi e Perseu dhe duke e mbushur tërë plagë e beteja errësirën e kripët. Shija e përpiktë e atij çasti ishte ajo çfarë po kërkonte tani; të tjerat s’kishin rëndësi: fyerjet e dyluftimit, beteja e ngathët, kthimi me tehun e përgjakur.

Një kujtim tjetër, brenda të cilit ishte gjithashtu një natë dhe rreziku i një aventure, shpërtheu prej tij. Një vajzë, e para që i falën zotat, e kishte pritur në terrin e një katakombi dhe ai e kërkoi nëpër galeri që thureshin si rrjeta të gurta dhe nëpër pjerrësira që fundoseshin në terr. Pse i vinin këto kujtime dhe përse i vinin pa asnjë hidhërim, si një paraimazh i së tanishmes?

Kuptoi me habi të madhe. Në këtë natë të syve të tij të vdekshëm, tek e cila po zhytej tani, e prisnin gjithashtu edhe dashuria, edhe rreziku, Aresi dhe Afërdita, sepse tani parandiente (sepse tani e rrethonte) një zhaurimë lavdie dhe heksametrash, një zhaurimë njerëzish që mbrojnë një tempull, të cilin zotat s’kanë për ta shpëtuar, dhe anijesh të errëta, që kërkohen nëpër det një ishull të dashur; zhaurima e Odiseve dhe Iliadave, të cilat ishin paracaktuar që ai t’i këndonte dhe t’i linte të jehonin në kujtesën e lugët njerëzore. Të gjitha këto i dimë, por nuk dimë se çfarë ndjeu, kur zbriti në terrin e fundit.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Ekuadori mposhti Katarin në ndeshjen hapëse të Botërorit

**AL KHOR, 20 NËNTOR** - Kupa e Botës nisi zyrtarisht më 20 nëntor dhe do të përfundojë më 18 dhjetor në finalen e madhe. Në ndeshjen e parë hapëse të vendit organizator, Ekuadori ka mposhtur 0-2 Katarin. Ndeshja nisi mjaft mirë për

Ekuadorin teksa që në minutën e tretë gjetën golin me Valencian por, ai u anulua për pozicion jashtë loje. Megjithatë, 13 minuta më vonë Valencia gjeti sërish golin këtë herë nga pika e bardhë e penalltisë. Duket se ishte dita e sulmuesit te

Fenerbaçe, i cili në minutën e 31-të gjeti sërish golin këtë herë me kokë duke e mbyllur sfidën me dopietë. Ekuadori ngjitet kështu në vendin e parë me 3 pikë në Grupin A, në pritje të sfidës tjetër të grupit Senegal-Holandë e cila luhet sot në orën 17:00.



## Prishtina pas dy vazhdimeve mposhti Trepçën, Vëllaznimi befason Pejën

**PRISHTINË, 20 NËNTOR** - Në një super ndeshje në kryeqytet, Sigal Prishtina pas dy vazhdimeve triumfoi ndaj Trepçës me rezultat 76:73 (15:16, 13:12, 17:16, 11:12, 20:17), në xhiron e 11-të të Prince Caffè Superligës. Ndeshja ka qenë e barabartë nga fillimi deri në fund, duke e bërë sfidën shumë interesante dhe fituesi të mos dihej deri në sekondat e fundit. Çereku i parë ishte tërësisht i barabartë, duke fituar 15:16, ndërsa periodha e dytë u karakterizua me shumë pak pikë të shënuara, ndërsa skuadrat shkuan në pushim me shifrat 28:28. Pothuajse lojë e ngjashme ishte në pjesën e dytë, ku periodën e tretë e fituan vendasit 17:16, ndërsa atë të fundit mysafirët 11:12, kurse aksionin e fundit nuk e shfrytëzuan prishtinasit dhe përballja shkoi në vazhdimë 56:56. Edhe në vazhdimin e parë ishte ndeshje e barabartë, ndërsa Jan Palokaj shënoi në fund për 67:67, duke e dërguar ndeshjen në vazhdimin e dytë. Faktikisht edhe vazhdimi i dytë ishte interesant, por prishtinasit ishin më të vëmendshëm dhe fituan 76:73. Te Sigal Prishtina debutoi Brooks DeBisschop me 24 pikë



e 14 kërcime, ndërsa u ndihmua nga Dustin Thomas me 12 pikë e tetë kërcime dhe Dardan Berisha me 16 pikë, gjashtë kërcime e tetë asistime, ndërsa

te Trepça u dalluan Drilon Hajrizi me 17 pikë e nëntë kërcime dhe Erjon Kastrati me 15 pikë e gjashtë kërcime. Prishtinasit kanë shtatë fitore e

katër humbje, kurse mitrovicasit gjashtë fitore e katër humbje. Ndërsa në ndeshjen tjetër, Vëllaznimi ka shënuar fitore të rëndësishme,

duke mundur Pejën në udhëtim me rezultat 82:91 (14:18, 26:13, 23:30, 19:30), në xhiron e 11-të të Prince Caffè Superligës. Në çerekun e parë mysafirët për një nuancë ishin më të mirë, duke e fituar këtë pjesë 14:18. Megjithatë, perioda e dytë 'foli' në të mirë të vendasve që ishin bindshëm më të mirë, si në mbrojtje dhe në sulm, për të shkuar në pushim me shifrat 40:31. Por, asgjë nuk kishte përfunduar, sepse kuqezinjët nuk dorëzohen dhe me lojë të sigurt ngushtojnë epërsinë në 63:61, sa ishte rezultati në semafor pas 30 minutash. Mysafirët vazhduan me lojë të mirë dhe bënë përmbysjen e madhe, ku në minutat e fundit u shkëputën, për tu mos u arritur nga vendasit dhe triumfuan 82:91. Jalen Tate u dallua te Peja me 35 pikë e gjashtë asistime, si dhe Rodney Purvis me 13 pikë e shtatë kërcime, kurse te Vëllaznimi u dalluan Anthony Adger me 21 pikë e shtatë kërcime, Emmanuel Emogbo me 15 pikë e 14 kërcime dhe Jordan Harris me 17 pikë e katër kërcime dhe Atik Koshi me 19 pikë. Peja ka tetë fitore e dy humbje, kurse Vëllaznimi ka pesë fitore e gjashtë humbje.

## Kosova luan me Poloninë për një vend në Botëror

**PRISHTINË, 20 NËNTOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll (femrat) do të përballlet me Poloninë në fazën e dytë kualifikuese për Kampionatin Botëror të vitit 2023. Kështu është vendosur me shortin e tërhequr në Lubjanë. Shorti vlerësohet i vështirë, por vajzat tona do ta japin më të mirën për sukses, përkatësisht për kualifikim. Ndeshja e parë luhet më 7/8 prill të vitit të ardhshëm në Poloni, ndërsa ndeshja e kthimit menjëherë

më 11/12 prill në Kosovë. Kosova për herë të parë luan në fazën e dytë kualifikuese për Botëror. Në fazën e parë e kaloi Kombëtaren e Ishujve Faroe. Kapitenja e Kosovës, Leonora Demaj e pranon se Polonia është kundërshtarë shumë e fortë. Sipas Demajt, Kosova duhet të luaj mbrojtje dukshëm më të fortë për të shpresuar në befasi. "Jemi në ngritje si Kombëtare, mirëpo kemi ende nevojë për përmirësime. Unë kam

besim në ngritjen tutje të Kombëtares sonë, mirëpo Polonia është Kombëtare shumë e fortë dhe ka përvojë më shumë se ne. Polaket paraqiten rregullisht në Kampionate Evropiane dhe Kampionate Botërore dhe kërkojnë suksesin. Gjëja më e rëndësishme për ne është puna në mbrojtje. Mbrojtja e fiton lojën", ka thënë Demaj. "Besoj që është pozitive që loja e dytë është te ne. Në ndeshjen e parë do të japim maksimumin dhe pastaj



kemi mundësi që të përgatitemi edhe më shumë për lojën e dytë. Po ashtu e

kemi edhe publikun si lojtarin e tetë", ka shtuar Demaj.



ROYAL CROWN



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

